

24875

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr 24875 .Akt

V E N D I M
PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date 28.12.2000 une gjyqtaria e Gjykates se Rrethit
Tirane M. Rendi si shqyrtova kerkesen dhe
materialin e paraqitur nga Ministria Ekonomise Publike dhe
Privatizimit per regjistrimin e shoqerise tregtare''
Ujesjelles Kanalizime Qytet'' Tirane

KONSTATOVA SE:

Kerkuesi Ministria Ekonomise Publike dhe Privatizimit ka
paraqitur kerkesen per te regjistruar si person juridik
shoqerine tregtare ne formen e nje shoqerie anonime''
Ujesjelles Kanalizime Qytet'' Tirane ,me kohezgjatje pa afat
te caktuar me aksioner te vetem Ministrine Ekonomise Publike
dhe Privatizimit, me kapital themeltar 2.008.900.000 leke
ndare ne 2.008.900 aksione, me vlere nominale 1000 leke me
objekt veprimtarie :

Prodhim dhe furnizim me uje te pishem I popullates dhe te
gjithe subjekteve qe veprojne ne Qytetin e Tiranës si dhe
largimi I ujrave te perdorura ne kete qytet.
Dokumentacioni I paraqitur, akti I temelimit, statuti, urdheri
nr. date i Ministrit te Ekonimise Publike dhe
Privatizimit dhe kerkesa per miratim eksperti jane te plota
dhe te bazuar ne ligj dhe si te tilla duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te Ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 ``Per shoqerite
tregtare'', si dhe nenit 33 te Ligjit Nr 7667 date
28.01.1993 ``Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe
duhen plotesuar ne te ``

V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime
``Ujesjelles Kanalizime Qytet'' Tirane me kohe zgjatje pa
afat te caktuar me kapital themeltar 2.008.900.000 leke me
aksioner te vetem Ministrine Ekonimese Publike dhe
Privatizimit, me vlere nominale te aksionit 1000 leke dhe
objekt veprimtarie: Prodhim dhe furnizim me uje te pishem I
popullates dhe te gjithe subjekteve qe veprojne ne Qytetin
e Tiranës si dhe largimi I ujrave te perdorura ne kete
qytet.

Keshilli Mbikqyres perbehet nga :

Zj.Dhurata Hoxha

Z. Xhemali Hani

Z. Qemal Stafaj

Kunder vendimit lejohet ankimi ne shkalle te dyte.

G J Y Q T A R E

Mariam Rendi
M. Rendi

AKT -THEMELIMI
I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 5.12 2000 ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit

VENDOSI:

1. Te krijoje shoqerine anonime'' Ujesjelles Kanalizime Qytet Tirane.
2. Objekti I shoqerise eshte: Prodhimi dhe furnizimi me uje te pishem I popullates dhe gjithë subjekteve qe veprojne ne Qytetin e Tiranës si dhe largimi I ujrave te perdorura ne kete qytet.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Tirane dhe ajo mund te cele dege, filiale, agjenci dhe perfaqesi ne te gjitha teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar eshte 2.008.900.000 leke ndare ne 2.008.900 aksione me vlere nominale 1000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
Zj. Dhurata Hoxha
Z. Xhemali Hani
Z. Qemal Stafaj
7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

